



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. asoc. dr. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 443/005
Dt 31.03.2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 22, paragrafit 1.7 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, në zbatim të nenit 150 të Statutit, nenit 20, 24, 25 dhe kreun e VIII të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, në mbledhjen e mbajtur më 31.3.2017, mori:

V E N D I M

1. Orari i plotë i punës në Universitetin e Mitrovicës zgjat 40 (dyzet) orë në javë, përkatësisht nga ora 08.00 – 16.00, përveç në rastet kur me vendim të veçantë për shkak të natyrës së mësimit caktohet ndryshe.
2. Personeli akademik që përveç në Universitetin e Mitrovicës ka edhe një marrëdhënie tjetër pune në ndonjë institucion brenda apo jashtë vendi, OJQ, kompani publike apo private, avokaturë, noteri, përmbarues privat dhe të ngjashme, obligohet që deri më **30.04.2017** të përcaktohet nëse do të ketë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e Mitrovicës apo jashtë universitetit.
3. Personeli akademik, i cili përcaktohet për marrëdhënie të rregullt pune me pagë primare në një institucion tjetër jashtë UMIB - it, nga Universiteti i Mitrovicës do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, nëse njësia akademike ka nevojë dhe jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UMIB – it.
4. Personeli akademik i cili mban poste publike jashtë UMIB - it përmes institucionit të konkursit publik, nga Universiteti i Mitrovicës do të kompensohen vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personalet të personelit akademik të UMIB – it.
5. Personeli akademik i zgjedhur apo emëruar në poste publike, gjatë periudhës së ushtrimit të postit publik, nga Universiteti i Mitrovicës do të kompensohen me pagë sekondare.
6. Personeli akademik si në pikën 4 dhe 5 të këtij vendimi, në rast të pezullimit të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë (5) ditësh pa pasur nevojë që t'i shpallet konkursi publik.
7. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, me kërkesë të arsyetuar, mund t'i lejohej angazhimi në mësimdhënie jashtë UMIB – it në një ditë të javës, në institucionet publike të Arsimit të Lartë në Kosovë me të cilat UMIB ka marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar.

- Kërkesa i drejtohet dekanit të njësisë akademike. Leja për angazhim lëshohet nga rektori. Angazhimi jashtë UMIB – it nuk do të lejohet, nëse më parë është refuzuar mbinorma në UMIB. Angazhimi mund të lejohet vetëm për një IAL.
8. Personeli akademik i cili përcaktohet për pagë primare në Universitetin e Mitrovicës, janë të obliguar që në Universitetin e Mitrovicës të punojnë sipas orarit të punës të përcaktuar si në pikën 1 të këtij vendimi, përveç në rastet e lejuara sipas pikës 5 të këtij vendimi.
 9. Anëtarët e Këshillit Drejtues nga UMIB, rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët mund të mbajnë më së shumti një normë mësimi, e cila nëse realizohet i llogaritet në kuadër të mbinormës, por nuk mund të kenë angazhim tjetër shtesë brenda dhe jashtë UMIB – it gjatë orarit të rregullt të punës.
 10. Mosrespektimi i afatit të përcaktuar si në pikën 2 të këtij vendimi do të nënkuptohet si pajtim i heshtur për kalim në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm.
 11. Mosrespektimi në çfarëdo forme i pikës 7, përbën arsye të mjaftueshme për fillimin e procedurës disiplinore pranë Këshillit Etik dhe shkëputje të kontratës me Universitetin e Mitrovicës.
 12. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit deri në miratimin e Rregullores për definimin e parimeve mbi punësimin, delegimin, nivelimin, promovimin suspendimin, shkarkimin dhe përcaktimin e nivelit të pagave dhe të kushteve të punës për personel.

Arsyetim

Duke pasur parasysh se një numër i konsideruar i personelit akademik të UMIB – it, përveç marrëdhënies së rregullt të punës në UMIB mbajnë edhe pozita tjera publike në institucione të ndryshme, dhe me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe vijueshmërisë në punë si dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, në kuadër të zbatimit të Ligjit të Punës dhe Statutit të UMIB - it, Këshilli Drejtues i UMIB - it lidhur me caktimin e parimeve të punësimit dhe kushteve tjera për personel, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Prof. asoc. dr. Sabri Sadiku

Sabri Sadiku
Kryesues i Këshillit Drejtues